



Datë: 16.05.2025

Numër Protokolli: 3237/2025

A.nr.568/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës–Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani-kryetar, Malsore Gashi- Bajraktari dhe Ardita Haxhnikaj -Demi-anëtarë me Rushit Kajtazi, në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr. 568/2024, të datës 28.03.2025, të parashtruar nga ankuesi F.G, me përfaqësues juridik avokat Hajzer Salihu kundër organit të punësimit: Ministria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, në çështjen juridik “kontestim konkursi”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 16.05.2025, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa më numër A.nr. 568/2024, e datës 28.03.2025, e parashtruar nga ankuesi F.G.

A r s y e t i m

Ankuesi F.G (me tej referuar vetëm ankues), më datë 28.03.2025, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e regjistruar nën shenjën A.nr.568/2025, me pretendimet ankimore se ankuesi sipas akt emërimit numër protokolli 4622 të datës 20.02.2013, ka mbajtur pozitën “ Drejtor i Institutit Bujqësor në Institutin Bujqësor të Kosovës në Pejë, duke pretenduar se me datë 26.10.2023, Komisioni Disiplinor i Ministrisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, përmes vendimit me numër protokolli 4504/2 ankuesit i shqipton masën disiplinore *pezullim të përkohshme nga puna sipas detyrës zyrtare në shërbimin civil nga data 26.10.2023, deri në nxjerrjen e një vendimi tjetër*” dhe njëkohësisht në piken tre të vendimit i shqipton edhe masën disiplinore ndalim nga 20% deri në 50 %, të pagës bazë për një periudhë gjatë (6) muaj, dhe se me datën 27.10.2023, ankuesi ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ndërsa Këshilli përmes vendimit A.nr. 1340/2023, të datës 27.12.2023, ka refuzuar ankesën e ankuesit si të pa bazuar, dhe se ankuesi kundër vendimit të Këshillit, me datën 22.01.2024, ankuesi ka hapur konflikt administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë Departamenti për

Çështje Administrative, me tej ankuesi ka pretenduar së Ministria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, ka publikuar konkursin reference RN00017323 për pozita e punës “Drejtor i Institutit Bujqësor ” në Pejë, duke pretenduar që Këshilli të aprovojë ankesën e ankuesit si të bazuar në ligj dhe të obligohet Ministria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, që të pezullojë shpalljen me numër reference RN00017323, të datës 21.03.2025, për pozitën “Drejtor i Institutit Bujqësor në Institutin Bujqësor në Pejë, derisa çështja paraprake të jetë vendosur me vendim përfundimtar të Gjykatës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejme referuar: Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datën 04.04.2025 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesën tek Ministria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, ndërsa kjo e fundit, më datë 15.04.2025, ka dorëzuar përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave administroi këto prova: Ankesën A.nr 2114/2025 të datës 28.03.2025; drejtuar Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Akt Emërimi me numër protokolli 462, i datës 20.02.2013, për F.G; Padi për inicimin e Konfliktit administrativ; Vendimi A.nr. 1340/2023, i datës 27.12.2023, i Këshillit; Konkursi me numër reference RN00017323, i datës 21.03.2025; Kërkesë për përgjigje në ankesë e datës 04.04.2025, dërguar përmes emailit nga R.K ,për F.M; Përgjigjen në ankesë me numër protokolli 568/2024, e datës 15.04.2025.

Kolegji i Këshillit pas shqyrtimit dhe analizimit të shkresave të lëndës të dorëzuara nga palët në procedurë si dhe pretendimeve ankimore të ankuesit, ka gjetur së ankesa është e pabazuar, sepse: Nga administrimi i provave të lëndës rezulton se Ministria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, më datë 21.03.2025, ka shpallur konkursin me numër reference RN00017323 për pozita e punës “Drejtor i Institutit Bujqësor ” në Pejë, klasa Drejtues i Mesëm, numri i kërkuar një (1) pozitë. Konkursi ka qenë i hapur për aplikim nga data 22.03.2025 deri me 20.04.2025.

Ankuesi me datë 28.03.2025 parashtron ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil duke kundërshtuar ligjshmërinë e procedurës se rekrutimit, , me pretendimet ankimore se ankuesi sipas akt emërimit numër protokolli 4622 të datës 20.02.2013, ka mbajtur pozitën ‘ Drejtor i Institutit Bujqësor në Institutin Bujqësor të Kosovës në Pejë, duke pretenduar se me datë 26.10.2023, Komisioni Disiplinor i Ministrisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, përmes vendimit me numër protokolli 4504/2 ankuesit i shqipton masën disiplinore pezullim të përkohshme nga puna sipas detyrës zyrtare në shërbimin civil nga data 26.10.2023, deri në nxjerrjen e një vendimi tjetër” dhe njëkohësisht në piken tre të vendimit i shqipton edhe masën disiplinore ndalim nga 20% deri në 50 %, të pagës bazë për një periudhë gjatë (6) muaj, dhe se me datën 27.10.2023, ankuesi ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ndërsa Këshilli përmes vendimit A.nr. 1340/2023, të datës 27.12.2023, ka refuzuar ankesën e ankuesit si të pa bazuar, dhe se ankuesi kundër vendimit të Këshillit, me datën 22.01.2024, ankuesi ka hapur konflikt administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë Departamenti për Çështje Administrative, me tej ankuesi ka pretenduar së Ministria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, ka publikuar konkursin reference RN00017323 për pozita e punës “Drejtor i Institutit Bujqësor ” në Pejë, duke pretenduar që Këshilli të

aprovojë ankesën e ankuesit si të bazuar në ligj dhe të obligohet Ministria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, që të pezullojë shpalljen me numër reference RN00017323, të datës 21.03.2025, për pozitën "Drejtor i Institutit Bujqësor në Institutin Bujqësor në Pejë, derisa çështja paraprake të jetë vendosur me vendim përfundimtar të Gjykatës.

Nga provat e lëndës, Kolegji i Këshillit ka gjetur se sipas vendimit me numër protokolli 4622 të datës 03.11.2023 të nxjerr nga Sekretarja e Përgjithshëm i Ministrisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, z. Arben Osmani, është caktuar në pozitën e ushtruesit të detyrës "Drejtor i Institutit Bujqësor në Institutin Bujqësor" në Pejë, si dhe sipas vendimit me numër protokolli 4316 të datës 13.11.2024 të nxjerr nga Sekretarja e Përgjithshëm i Ministrisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, i njejtë është caktuar në pozitën e ushtruesit të detyrës "Drejtor i Institutit Bujqësor në Institutin Bujqësor" në Pejë, dhe se në kuptim të Nenit 35 të Ligjit nr. 08/l-197 për Zyrtarët Publik, ku përcaktohet se; *1. Në rast se një pozitë e nivelit drejtues brenda strukturës organizative të institucionit mbetet e lirë, nëpunësja/i i nivelit të lartë drejtues e atij institucioni e cakton me vendim ushtruesen/in e detyrës për pozitën e lirë. 2. Në pajtim me paragrafin 1. të këtij neni, ushtruesja/i i detyrës mund të caktohet zyrtarja/imë i lartë i kategorisë pasuese, në vartësi të pozitës që caktohet, nga cilado njësi organizative brenda institucionit. 3. Zyrtarja/i publik nuk mund të caktohet si ushtruese/i detyre më gjatë se gjashtë (6) muaj. Kur pozita nuk mund të plotësohet brenda afatit gjashtë (6) muaj, ky afat mund të zgjas më së shumti edhe për gjashtë (6) muaj të tjerë. 4. Pozita e lirë nuk mund të zëvendësohet me ushtrues detyre për më gjatë se afati i përcaktuar në paragrafin 3. të këtij neni. 5. Çdo vendim i marrë nga ushtruesja/i i detyrës, pas kalimit të afatit të përcaktuar në paragrafin 3. të këtij neni, është i paligjshëm.*; si rrjedhojë, Kolegji i Këshillit, konstaton se zëvendësimi i kësaj pozitë drejtuese, me anë të këtyre akteve të sapo theksuara rezulton të ketë tejkaluar këtë afat ligjor prej një viti, e si për rrjedhojë, kjo pozitë pune e kategorisë së drejtues nuk mund të zëvendësohet më tutje me ushtrues detyre.

Andaj, Kolegji i Këshillit duke u bazuar në konstatimin e lartë dhe dispozitat e lartcekura konstaton së pozita "Drejtor i Institutit Bujqësor në Institutin Bujqësor në Pejë, që nga vitit 2023, është e pa plotësuar dhe sipas vendimit A.nr. 1340/2023, të datës 27.12.2023, të Këshillit ku përmes këtij vendimi Këshilli i ka refuzuar ankesën e ankuesit si të pa bazuar, në ligj, duke lënë në fuqi vendimin me numër protokolli 4501/4, i datës 27.10.2023, të Komisionit Disiplinor i Ministrisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, me çka nënkuptohet së pozita "Drejtor i Institutit Bujqësor në Institutin Bujqësor në Pejë, është pozitë e pa plotësuar nga nxjerrja e vendimit të Këshilli në vitin 2023, deri në shpalljen e konkursit numër reference RN00017323, të datës 21.03.2025, për pozitën "Drejtor i Institutit Bujqësor në Institutin Bujqësor në Pejë, nga Ministria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.

Prandaj bazuar në konstatimet si me lartë, Kolegji i Këshillit konstaton se në rast të një pozitë në Shërbimin Civil si pozitë e pa plotësuar sipas dispozitave ligjore nenit 35, sipas arsytimit të këtij vendimi nuk mundë të jetë e pa plotësuar me gjatë se afatet e përcaktuara ligjore, Kolegji i Këshillit konstaton se pretendimi ankimore i ankuesit është i pa bazuar sa i përket shpalljes së konkursin reference RN00017323 për pozita e punës "Drejtor i Institutit Bujqësor " në Pejë, e zhvilluar nga Ministria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.

Këshillë juridike: Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda: A.nr 568/2025

Rushit Kajtazi

Procesmbajtës

Eshref Shabani

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Përfaqësuesit të autorizuar të ankuesit Hajzer Salihu;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural;
- Arkivit të KPMSHCK-së.